

AKTI I THEMELIMIT TE SHOQËRISE ANONIME “BALKAN INTERACTIVE GROUP (BIG)” ShA

Sot, më 26/08/2022 (dymijë e njëzete e dy), themeluesit “Valona Konstruksion” sh.p.k, dhe “Entertainment & Gaming sh.a krijojnë një shoqëri aksionare me emrin “Balkan Interactive Group ” ShA. (me ofertë private).

Themeluesi i shoqërisë, “Valona Konstruksion” sh.p.k, person juridik shqiptar, i regjistruar pranë organeve tatimore me NIPT, K26330202E, në datën 30/01/2002, në formën ligjore SH.P.K, e themeluar në datën 22/08/2001, me përfaqësues ligjor z. Bujar Lulaj, i datëlindjes 19 /11/1963 lindur në Vlore , titullar i ID me nr G31119059J, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar,

Themeluesi i shoqërisë, “Entertainment and Gaming” sh.a, person juridik shqiptar, i regjistruar pranë organeve tatimore me NIPT, M02424014D në datën 24/12/2020 në formën ligjore SH.A, e themeluar në datën 22/12/2020 me përfaqësues ligjor z. Besnik Lulaj i datëlindjes 26/03/1967 lindur në Vlore , titullar i ID me nr G70326115V madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, bazuar në vendimet e tyre te Asamblese se pergjithshme te Aksionereve nr. 23 datë 19/08/2022 dhe vendimin e Asamblese se Pergjithshme te Ortakut te vetem nr 67, date 18 /08/2022, vendosen te themelojnë shoqërinë anonime të emërtuar “BALKAN INTERACTIVE GROUP” Sha, dhe hartojnë për këtë qëllim Aktin e Themelimit të shoqërisë me përmbajtje si vijon:

Neni 1 Emri i Shoqërisë

Shoqëria emërtohet “BALKAN INTERACTIVE GROUP” Sh.a

Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët “Shoqëri Anonime” ose inicialet sh.a.

Neni 2 Forma e Shoqërisë

2.1 Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë anonime me ofertë private, për sa kohë që Asambleja e Aksionereve nuk do të marrë një vendim për shndërrimin e saj në një shoqëri anonime me ofertë publike.

2.2 Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.



Neni 3 **Selia**

3.1 Shoqëria e ka selinë në Shqipëri, Tiranë, Rruga “Ismail Qemali”, Pallati Nr. 34, Kati 2.

3.2 Përveç veprimtarisë në nivel lokal, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, agjencive dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

3.3 Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të Këshillit të Mbikqyrës, me kusht që ky vendim të miratohet nga mbledhja më e afërt e Asamblesë së Aksionarëve.

Neni 4 **Objekti**

4.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm: Prodhim dhe operim i software për lojra fati, Operim dhe menaxhim i sallave të lojrave të fatit, projektim, menaxhim, operim, ndërtim i kazinove, prodhim i makinave të lojrave të fatit, importim – eksportim dhe dhenien me qera te tyre, import-eksport i pjesëve të makinave të lojrave të fatit dhe dhenie me qera te tyre, zhvillim dhe operim i livegaming dhe online gaming , si dhe sherbime te kembimit valutor. Krijim dhe operim i bareve dhe restoranteve, import – eskport ushqimesh , pijesh dhe lende te pare. Ne funksion te zhvillimit te veprimtarise se Kazinos, organizim eventesh, koncertesh, muzike live dhe turne te ndryshem, sherbime turistike dhe mikepritese. Ofrim dhe zhvillim te kurseve, trajnimeve te formimit profesional, ne programet dhe kurset e percaktuar prej tij. Transport te udhetareve e te mallrave brenda dhe jashte vendit.

Shoqëria mund të kryejë veprimtari të tjera të lidhura apo në funksion të objektit të mësipërm.


Për ushtrimin e aktivitetit shoqëria do të pajiset me licensat përkatëse kompetente.

Neni 5 **Kohëzgjatja**

5.1 Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar / e pakufizuar

5.2 Në përputhje më këtë statut, shoqëria mund të mbyllë veprimtarinë e saj kur e shoh të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

Neni 6 **Kapitali Themeltar**



Kapitali i regjistruar i shoqërisë është **1,207,976,345 leke** (*nje miliard e dyqind e shtate milion e nenteqind e shtatedhjete e gjashte mije e treqind e dyzete e pese leke*) i ndarë në

1,207,976,345 leke (*nje miliard e dyqind e shtate milion e nenteqind e shtatedhjete e gjashte mije e treqind e dyzete e pese leke*) aksione të zakonshme me vlerë nominale **1 (një) Lekë secili**.

Aksionet e themeluesve në kapitalin e shoqërisë janë në përputhje me kontributin e tyre të mëposhtëm:

Aksionari themelues	Shoqëria “Valona Konstruksion” sh.p.k
Lloji i kontributit:	Në natyrë
Numri i aksioneve:	99%
Vlera e aksioneve:	1,195,896,582 leke (<i>nje miliard e njeqind e nentehjete e pese milion e teteqind e nentehjete e gjashte mije e peseqind e tetehjete e dy leke</i>)
Kontribut në natyrë paluajtshme)	1,195,896,582 leke (prona, pasuri të

Aksionari themelues	Shoqëria “Entertainment and Gaming ” sh.a
Lloji i kontributit:	Para
Numri i aksioneve:	1%
Vlera e aksioneve:	12,079,763 leke (<i>dymbedhjete milion e shtatedhjete e nente mije e shtateqind e gjashtehjete e tre leke</i>)
Vlera e kontributit:	12,079,763 leke (<i>dymbedhjete milion e shtatedhjete e nente mije e shtateqind e gjashtehjete e tre leke</i>)

**Neni 7
Aksionerët**

7.1 Aksionerët e shoqërisë janë persona fizikë dhe juridikë që kanë vënë ose do të vënë në

zotërim aksione të shoqërisë me të gjitha mënyrat e parashikuara nga ligji dhe nga ky statut.

7.2 Zotërimi i aksioneve të shoqërisë u jep atyre të drejtën të marrin pjesë në Asamble dhe në votim në përpjesëtim me aksionet që zotërojnë.



7.3 Aksionerët kanë të drejtën e votës dhe të përfaqësimit në Asamblenë e aksionerëve me kushtet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe statuti.

7.4 Votat që zotërojnë aksionerët janë proporcionale me përqindjet e aksioneve që zotërojnë.

7.5 Çdo aksioner i shoqërisë ka të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e shpërndashme të shoqërisë në përputhje me aksionet e tij sipas vlerës nominale të zotëruar prej tij në kapitalin e shoqërisë.

7.6 Çdo aksioner ka të drejtë të marrë, kur është rasti, një tepçicë nga likuidimi i kapitalit në përpjesëtim me vlerën e aksioneve që zotëron.

7.7 Aksionerët e shoqërisë janë vetë përgjegjës për detyrimet dhe për humbjet e shoqërisë, deri në kufirin e vlerës nominale të aksioneve që zotërojnë. Përgjegjësia tej këtij kufiri është e ndaluar.

7.8 Të drejtat dhe detyrimet e përmendura më sipër ndjekin aksionin në çfarëdo forme që ai të tjetërsohet tek të tretët.

7.9 Transferimi i aksioneve nuk mund të kryhet pa nënshkrimin e administratorit dhe pa miratimin e të dy aksionerëve.

7.10 Aksionarët e Shoqërisë “**Balkan Interactive Group**” ShA janë “Valona Konstruksion” sh.p.k, dhe Entertainment and Gaming sha

Neni 8

Organet e Shoqërisë

Organet e shoqërisë aksionare janë:

- Asambleja e përgjithshme;
- Këshilli i Mbikqyrës
- Administratori/administratorët

Anëtarë të parë të Këshillit Mbikqyrës janë:

- **Z. Patrik Kaca, atësia Gjergj, datëlindja 25/10/1997** shtetas shqiptare, i regjistruar me nr. personal - J71025048F, Kryetar Keshilli

Z. Jetmir Shabani, atësia Haki, datëlindja 13/10/1990 , shtetas shqiptar, i regjistruar me nr. personal J01013123F, Anetar

- **Z.Ardit Shehaj, atësia Eduart datëlindja 23/09/1990**, shtetase shqiptare, e regjistruar me nr. personal J00923003I, anëtar.

Administrator i shoqërisë emërohet **Administratori: Besnik Lulaj, atësia Fecor datëlindja 26/03/1967, lindur në Vlore banuese në Tirane**, shtetas shqiptar, i regjistruar me nr. personal G70326115V.

Neni 9

Kontrolli i Shoqërisë Ekspertët Kontabël të Autorizuar



9.1 Me propozim të Këshillit Mbikqyrës, Asambleja e Përgjithshme me vendim të zakonshëm emëron një ose më shumë persona fizikë ose një shoqëri auditimi si ekspertë kontabël të autorizuar të pavarur të shoqërisë për një periudhë nga 1 (një) deri në 3 (tre) vjet me radhë, sipas permbajtjes së vendimit. Ekspertët mund të shkarkohen mbi bazën e një vendimi të marrë me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme.

Ekspert i parë kontabël i shoqërisë të emëruar për një mandat 1 (një) vjeçar caktohet: **Haxhi Audit and Consulting shpk**, me NIPT L92427006M, me nr.licence 442 , me administrator /auditues ligjor Znj.Almarina Haxhi, atësia Ilirjan, datëlindja 12/11/1986, lindur në Sarandë, banues në Tiranë, shtetas shqiptar, i regjistruar me nr. personal I66112066S.

Dhe

Studio L.E.A.L AUDITING sh.p.k me NIPT K83814801N, me nr.licence. 24 me auditues ligjor Znj. Leze Abazi , atësia Tom , ditëlindja 26.01.1963, lindur në Blalke, banues në Tiranë, Shtetas shqiptar, i regjistruar me nr.personal G35126037W

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje midis palëve kontraktuese do të zgjidhet me mirëkuptim, në rast të kundërt, palët do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

AKSIONARËT THEMELUES TË SHOQËRISË

“ENTERTAINMENT & GAMING” SHA

Përfaqësues ligjor **Z.Besnik Lutaj**



Besnik Lutaj
Josefina

“VALONA KONSTRUKSION” SH.P.K,

Perfaqesues Ligjor **Z.Bujar Lutaj**

Bujar Lutaj *Bujar*

